

NDIKIMI I SHQIPES MBI TË FOLMET SERBE TË KOSOVËS Leksikologjia

Murat Blaku

Prishtinë

KUD 809.198.3:808.61(497.115)
Punim studimor

Marrë për botim, më 22 nëntor 1994

Përmbajtja e shkurtër: Punimi rrah aspekte të gjera të trysnisë së shqipes mbi ligjërimet serbe të Kosovës në fushën e leksikut. Analizohen edhe dukuri të lëvizjes semantike, në radhë të parë te disa folje (fenomeni i ekstensionit semantik) po në ndikimin e shqipes së Kosovës. Një ndikim i dukshëm konstatohet në fushën e frazeologjisë e të frazeologjizmave, të stilistikës gjuhësore etj.

5.1.0. Çështje të semantikës në interferenca leksikore

5.1.1. Pasqyrën më të plotë të huzimeve të shqipes në leksikun e këtyre ligjëtimeve e jep fjalori i G.Elezoviçit *Rečnik kosovsko-metohiskog dijalekta*.¹ Por ndeshen në materialet e studiuara edhe mjaft fjalë që s'gjenden te kjo vepër. Fondin e fjalëve të shqipes aty e ka studiuar shterrueshëm I.Ajeti². Atij i dalin në këtë fjalor rreth 300 fjalë të shqipes.³ *Kjo s'është për t'u habitur, ngase nënsistemi i leksikut siç është theksuar edhe më parë, është fusha ku më së lehti depërtojnë elementet e huaja gjuhësore, ndërsa kontaktet ndërmjet dy gjuhëve, nga ana tjetër, kanë në këto hapësira një traditë shumëshekullore të pandërprerë, me një shkallë të tillë afërie që rezultoi me procesin e vazhdueshëm, herë më shumë e herë më pak, të bilinguizmit, sa herë të përmendur deri tash. Shikuar për nga kriteret e cilësimit të tyre, ato për nga rruga e huazimit janë, kuptohet, të drejtpërdrejta, nga përmbajtja të plota, ndonjëherë edhe strukturore, ndërsa për nga shkalla e depërtimit në gjuhë, dalin të rrënjosura.*⁴

1 Shih G. Elezoviç: *Rečnik kosovsko-metohiskog dijalekta*, I, Beograd, 1932; II, Beograd, 1935. Është fjalor i vetëm dialektor i serbokroatishtes deri sot.

2 Shih I. Ajeti: *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, I, Prishtinë, 1982, 54-77 dhe te *Studije iz istorije albanskog jezika*, Priština, 1982, 76-98, fillimisht te *Gjurmime albanologjike*, II, Prishtinë, 1965, 35-56.

3 Shih I. Ajeti, aty, 54.

4 Për kriteret e klasifikimit të huazimeve shih R.Filipoviç: *Teorija jezika u kontaktu*, 155-157; J.Thomaj: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, 192-193.

5.1.2. Vështruar për nga kiriteri *i përmbajtjes*, më shumë se tipi i parë, me interes del i dyti, kur kalkimi mbështetet kryesisht mbi komponente të caktuara të aspektit semantik. Në këtë pikëpamje procesi i kalkimit të disa kategori leksikogramatikore ka vajtur aq thellë, sa ka shkaktuar edhe lëkundje serioze të përbërësve semantikë të bërthamës kuptimore të fjalëve (angl.*semantic shifts*)⁵. *Te disa folje, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të shqipes, është shkaktuar i ashtuquajtura ekstension⁶ semantik, që do parë brenda tre faktorësh kryesorë: a) të shkakut, b) të natyrës së ndërrimit dhe c) të pasojave që lë prapa.*⁷ Të tilla janë, ndër të tjera, foljet si **doneti (donositi): dovesti (dovoditi), odneti (odnositi); povesti (poneti), vratiti** (šta): **okrenuti** (šta), në shembujt si: *Očeš li da me pustiš...da prenoćim? O, oču, kako da ne! Bog te doneja, dobro si doša!* (N.P.I,37) (= poslao, doveo); (=Meandja njega odmah dovoti stranca.:M.B) pa odnese u sud i tuzi ga... (D.D.d.d. 62) (=odvede, sprovodi); Car doznade za onu decu...pa odmah zapovedi za njih da se donesu (aty, 63) (=da se dovedu, sprovode); Jedan se čovek ozenio. Posle je hteo da nosizenu u prvič (aty, 136) (=da vodi, odvede) Na česmu gu našli vragovi (=devojk.:M.B.), uzeli gu i odneli u šumu (N.P.I,46) (=poveli je, odveli); On je otišao kod njojzi i hteja da gu uzme i odnese doma (aty, 47) (=odvede, povede); Prati me car tu i tu, ako ne mi doneseš od toga kralja neku devojk (aty, 158) (=dovedeš, povedeš) ose në vargje:

"Čuješ, kaze, moja verna ljubo!

Nosi doru (=konja.:M.B) Petru pobratimu

Nek mi kove konja veresije!

Odnese mu konja verna ljuba". (DS.I, 279)

(=vodi, odvede; odvede)

"Razljuti se care gospodare,

Te dovati Stefana od Rusije,

Te ga odnese u Stambola grada..." (aty, 281)

(=sprovodi ga, pošalje ga, odvede ga)

"Čujes mene, Sultana devojko

Da te nosim u ravno Kosovo..." (aty)

(=vodim, odvedem)

Nema kude Pavlovića ljuba

Pa govori Pavlu gospodaru

Ponesi me do taj raji bozji

.....

Ponesi me kud ruze crvene

.....

Ponese gu Pavle gospodare..." (D.D.I, 166)

(=povedi me, povede je)

5 Shih R.Filipović, aty 157.

6 Ai, aty.

7 Ai aty.

"...*Ode doma Sokolić Mustafa
donese mu prelepu nevestu...*" (aty, 193)
(=*dovede mu*)

"*I tad stade crni Arapine,
Vrati glavu, gleda u planinu,
tad govori Gruica vojvoda:
Tegli konja, Arape gospodare,
što ti slušaš što kozari i zboru...*" (aty, 291)
(=*okreće glavu*)

Cilat janë arsyt e një fenomeni të këtillë? a) *Shaku kyesor* qëndron në faktin se fusha semantike e foljeve të theksuara këtu, në ligjërimet shqipe të Kosovës i ngërthen thuaja krejtësisht edhe kuptimet e tyre dhe në këto të fojme, në kontekste si këto, s'ndihet ndonjë mangësi kuptimore e dukshme. **Bie** (prura, prurë) në shqipen kosovare pothuaj se brendapërfshin edhe sinonimin e vet **sjell**, prandaj në vështrimin "mbart diçka nga vendi ku është dhe e sjell afër, sjell" kjo folje përdoret shumë rrallë, ose s'përdoret fare. Në këto ligjëtime të shqipes, **sjell** si duket kuptimisht përqëndrohet më shumë në domethënien e homonimit të saj "rrotulloj, vërtit", në diat. vetvetore: "kthehem nga një anë a nga një drejtim; bëj një lëvizje në trajtë rrethi...; bredh poshtë e lart...". Prandaj ky **ekstension** që u realizua te folja **bie**, me gjasë u perceptua dhe u bë receptiv edhe për serbishtfolësit dhe u shtri në fushën semantike të këtyre serbishteve të foljes **doneti**, që mori edhe kuptimin e **dovesti**, **dovoditi**. Po kështu edhe te **poneti**, **povesti**. Në shqipe, në kontekstet si më sipër, për këto dy kuptime përdoret "marr me vete, çoj". Edhe për **odneti**, **odvesti** shqipja ka "marr, marr me vete, çoj, shpie", është pra një rrafshim që s'i diferencon muancat kuptimore që i ka serbokroatishtja, e që si duket u bë i natyrshëm edhe për ndjenjën gjuhësore të serbishtfolësve. Ky njësim semantik si duket pasqyrohet edhe te **vrati glavu**, se në shqipen **ktheu kokën** mbërthen edhe **okreće glavu**, prandaj edhe këtu refelektohet modeli i shqipes; b) *Natyra a karakteri* i ndërrimeve të këtilla të kuptimeve, prek në individualitetin gjuhësor, në thelbin e komponenteve të diferencuara semantike, që në serbokroatishte janë të zhvilluara mjaft dhe me kufij të qartë kuptim dallues. Një depërtim i tillë në këtë sferë i ndikimit nga jashtë, dëshmon për cilësinë e raporteve ndërmjet dy gjuhëve; c) Pasojat e një dukurie si kjo, u muar vesh, çojnë nga rrudhja e mundësive për shfrytëzimin e begatisë që ofron shumësia e formave të njësive leksikore të mbushura me semantikë të nuancuar, si parakusht i shprehjes më me veçanti e saktësi kuptimore. Rrjedhimisht, fenomenet e këtilla e bëjnë indin semantik të fjalëve dhe pasqyrohen negativisht në sistemin leksikor. Mirëpo ky proces, siç del nga materialet e konsultuara, është shumë i kufizuar.

5.1.3. Kalkimi që s'prek në ndryshimin e nuancave kuptimore semantike, është më i përhapur. Modeli merret me tërësinë e kuptimit semantik dhe bartet në replikë qoftë pavarësisht nga konteksti, qoftë i kushtëzuar prej tij. Kap folje, ndajfolje, mbiemra etj. Zakonisht pasqyron drejtpërdrejt prejardhjen e tij, ngase

për serbishtfolësin jokosovar është diçka që s'e duron ndjenja gjuhësore e përgjithshme. Shpeshherë, po s'u përqasën me shqipen, vështirë kuptohen: **Çekajte toga psa, ne dajte, se ponese opance** (OR.211) (Pritnie, trembënie qenin=ispudite, gonite, izjurite psa); *em je gledan, em domaćin, em je mudar* (aty, 190) (i pashëm", i bukur"=lep, ličan, zgodan); **gledan**⁸ *čovek, gledna devojka* (EF, I, 98); *Piješ li gospodine duan? Ne pijem* (EF,II,156) (*a pi duhan zotëri? Nuk pi= pušiš li gospodine? Ne pušim*); *U staro vreme ljudi su pili duan na čibuk* (aty, 245); *Ubiva me jemenija* (aty, 376) (më vret këpuca= zulji me cipela); *Ovna odjedanput pade mrtav. Ovi mu odraše kozu i uviše dete ubiveno* (D.D.d.II, 64) (fëmijën e lënduar, në Kosovë: fëmijën e vramë = ozledjeno dete); *Ič mu nemo ni razbivat krupne pare, kad ne pazaruje kod nas* (aty, 160); *Idi razbi mi ovu frangu kod sarafa* (aty, 541) (Thyej, i bëj të imëta paratë= usitniti, menjati novac); *Na šort je da gu obalu* (aty, 1) (a është) në short; ka mundësi, ka gjasë = moze biti, moze da se desi); *Sta ti pada tebe zivko pop Dančetov?* (aty, 534) (çka të bie, ç'e ke= šta ti dolazi) *Zajeli se ka besni psi* (SNPKM ,⁹ 49) (*u hëngrën, u fjalosën= posvadjali se*); *Steze konja ašik kapetane* (D.D.I,198) (shtrëngoi, e përgatiti kalin=spremi konja); *Radili su neku radnju...i jedan je dobro dobio* (NP,II,28) (fitoi mirë= dobro zaradio); *Da li je vuk? Baš je vuk!... Ne smem da vičem jer će me zgrabiti, a vrata mi uhvaćena* (NP,II,93) (e dera e zënë= a vrata zauzeta). Shembuj të këtillë ka shumë. Këta u zgjodhën si më tipikë. Procesi i kalkimit nga shqipja ishte i fortë. Ai arriti edhe deri te imitimi i modelit të mjeteve të shqipes në ndërtimin e ndonjë ndajfoljeje, si *përse* (në Kosovë edhe për çka), *përnjëmend* etj.: *Zbogša se boji?* (EF,I,203) (përçka frigohet=çega se boji); *To je Stojan zistina primio* (aty, 210) (e kuptoi, e mori përnjëmend=zaista). Ai ka prekur fuqimisht edhe gjymtyrë të fazeologjizmave, siç do të shihet në paragrafët përkatës.

5.1.4. Huazimet nga shqipja në fondin leksikor të ligjërimeve serbe në vështrim janë të rrënjësura. Këtë e tregon integrimi i tyre në shtresën asnjënëse të tij pastaj fakti që gati asnjëherë nuk marrin ngjyrim stilistik emocional dhe që nuk janë konsideruar në ndjenjën gjuhësore si elemente të huaja. Kjo provohet nga e dhëna që ato ndeshen shpesh si njësi semantike të zakonshme në korpusin e fjalisë, po edhe si gjymtyrë të rëndomta të saj, me funksion sintaksor si në gjuhën prej nga kanë hyrë:... *Leteo sa jednoga kamena...te se tako pštonjao od sigurne smrti* (NP,I,133); *Da nesam more ja gabonjao što reko...* (NP,II, 25); *Ona je posle sedela...i ništa nije radila. Ostala je krejt gola* (D.D. d.d. 120); *Pa nesu u jednu godinu, ali oba mladi krejt* (aty, 160); *Crni brate, ti si krejt istruo pamet* (OR,189); *Pazim...da nema nekoga na pritu* (D.D.d.d. 153) *Pus mu je rabota* (EF,II, 1507); *Za jedan sat učinijo je bašču pus* (aty): *Ima far para? Toga far čoveka; Jedan far paprike; U nasu faru nije imao lovač; Ti, tvoju cigansku faru! Taka gi je fara* (EF,II,404); *Turli far vezu, turli far šiju, turli far pleteju* (D.D. d.d. 209); *Pokloni vi faj* (NP,I,61); **Ufatiše se fit**

⁸ Mbiemri *gledan* në këso konstruktesh s'ka të bëjë me vidjen "i shquar, me autoritet, eminent".

⁹ Shkurtesë për Srpske narodne poslovice sa Kosova i Metohije (autor V.Cvetanović).

pr fit (EF,II,411); *Uzeli ga Bunjaci mendore* (EF,I,398); *Priçao je neke priçe, poknaçijo je; Veçerali smo kod njega, poknaçili smo se* (EF,II,95); *Plemenske stvari raspravljaju krene; Skupile se krene da miru krvove* (EF,II,326); *Moçno ti liçni krenisanje* (OR,372); *Kad mnadica dodje u novi dom, svekra zovebabo, svekrvu-majko, devere: mildever, dever-pisar, deverkrenija, devervojvoda...* (aty, 243); *Skini teše pa idi da bereš trave* (aty 376); *Predlozi on... da pozove pljaçniju; Ne treba brate da zovemo pljaçniju, mozemo i sami da se podelimo* (OR,161) *Pljaçnija raspravlja o sluçaju i donese odluku* (OR, 381); *Ti da imaš nerziju, tako ne bi činijo; Nikaku nerziju nema* (EF, I,459); *Besa je sadena iskvarena; Pod besu je; Uzeo ga...na besu* (EF,I,43); *Çrepala mu je puska, se bi ga ubio* (EF,II,453); *Duçan mu je tangal; Duçan mu se tavako tangal učinijo* (EF,II,299); *Iç ne sedi, kaj tarak, a tamo, a ovamo* (aty, 300) - shpjegimi që jep Elezoviçi këtu s'është i mbështetur. Fjala është për "ka a dem të patredhur"; *Çuvajtje ga, se on će tretit negde; Tretijo je on u svet; Tek dokle tretu na neku stranu* (aty, 337); *Da mi daš tuljine za birek* (aty, 346); *Tuto tutavi; O tuto* (aty, 351); *Çebesako ti dodjem, upantiçeš me* (aty, 357) etj. Mjetet leksikore të shqipes, në krijime popullore gojore, në dialogë formash të fjalëve të urta, tekste lojërash të fëmijëve etj. shpesh e mbizotërojnë leksikun e serbishtes, ose janë thjesht shqipe, me ndonjë element të turqishtes: *Kuje more ljaper? će more za beter* (tj. de si more ljaper - eve sam more da beter) (D.D.d.d.179); *Pić, pić, krasnić /ćeta mera, ćeta ić.*¹⁰ (aty, 170. Këtu, nëse *pić, pić* mund të jetë improvizim për nevoja rime, *mera*, do të jetë gabim shtypi, se është urdhërorja e *marr: merre*, sikundër edhe *hiq*). Këto huazime shpesh u përshtaten edhe kërkesave fjalëformuese (afiksale) të serbishtes kur e do puna e shprehjes së diferencuar kuptimore, marrin edhe mbaresa vetore të foljeve të saj, pra integrohen në sistem (shih *pštonjao, gabonjao, poknaçili, uknaçiti*): *uknaçili ste rabotu* (EF, II,387) pastaj *Ufikio ga Bog; Uleze u tu rabotu te se ufiki* (aty, 399), *Valjalo bi neko da ga operdaši; Valja mi još ovo malo da operdašim* (aty 31) në Kosovë *përdah* "përzë, dikë, e rëndo me fjalë"; ndoshta në kontekstin e dytë ka të bëjë edhe me *perdah-u, përdaf-i*, me vështrimin që e jep FGJSH¹¹ përkatësisht f.1401 e 1424); *skundjiti se, skunjiti se, ukunjiti se; što si se skundjijo tu kaj uboznik* (aty, 237); *Ene ga ono belo pile nešto se skunjilo, kaj da je bono* (aty); *Nešto se ukunjio, da nije bolan?* (aty, 543). Formën *skunjiti se, skunjim se* e ka edhe Fjalori i Vukut. Trajtat e em. *kunj*, në Kosovë *kunxh* që me konversion kaluan në folje *kunjoj, kunxhoj* dhe që në shqipen kanë domethënien fig. "Thumboj a ngacmoj dikë me fjalë therrëse, i hedh kunja", e që në Kosovë do të thonë edhe "rri në një vend dhe, për një shkak a një tjetër, nuk lëviz" dëshmojnë qartë prejardhjen e këtyre foljeve në ligjërimet serbe të Kosovës. *Rascopali su mu glavu sas kolac* (aty, 170), *Rascopat...*(OR, 418) te Fjalori i Vukut *rascopati, rascopam*, svr. *Nemoj da ošljariš, no a brzo rabotaj. Tako je kad se ošljari, a ne rabota se kaj što treba* (EF, II,48. Do të jetë sipas të gjitha gjasave nga **lëshoj** me metatezë **shloj**; në

¹⁰ Kjo s'është për t'u çuditur, ngase edhe leksiku i turqishtes, nga shek.XVII deri në shek. XIX shpesh mbizotëroi, e në ndonjë të folme faktikisht e shtypi krejtësisht leksikun vendës (shih D.Barjaktarević: *Dijal. istraz.* 23-24).

¹¹ Shkurtesë për Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, I,II, Prishtinë, 1981.

kosovar. e ka lshue krejt "s'punon, ëshë demoralizuar"), etj. Pa elemente efikase po me mbaresë vetore të kësaj gjuhe: Uptisa me taj çovek; *Uptisasmose sas ovu prokletu vergiju* (EF, II,393) kosovar. *hup "humb"*); *Ova moja grbina ne moze vise da cindroše-Dosta je i cindrosala* (aty, 365). Përveç këtyre elementeve, huazimet nga shqipja kanë depërtuar pak a shumë në pjesën më të madhe të sferave të jetës së përditshme, emërtojnë edhe nocione abstrakte të këtyre ligjërimeve.

5.2. Në fushën e fjalëformimit të këtyre të folmeve nuk hetohet ndonjë ndikim i dukshëm i ndajshesave të shqipes. Ka pak gjurmë të ndonjë prapashtese të emrave të gjinisë femërore si: *ajdukeša*, *kradljivica* (EF,I,6) *turkeša* (EF,II,350), *potureša*: *Ubiću sebe i Jevku poturešu* (DD,I,105) (këtu me prefiks të skr.) *krućeša* "ime krave crvene dlake" (EF,I,348); *kukaveša* "kukavica" (aty, 340), *gogeša* "zensko čeljade koje je po rodu Goga, gogina 'ena" (aty, 102) - me dyfishim prapashtesash. Për etimologjinë e prapashtesës së shqipes *-esha*¹², dihet që ajo konsiderohet me prejardhje nga lat., lidhet me *-issa*. Është e vjetër, se e ka edhe Buzku *mikeshë*. Te emrat mashkullorë gjendet ndonjë prapashtese si-*tor*: *fišektor* "fišeklija, redenik" (EF,II,411) (në shqipen emër i gjinisë fem.), *-an* (me prejardhje sllave, po ja në shembujt si këtu, që u mor nga shqipja): *ćućan: što ne ulegneš u sobu, ćućane moj, tu ćeš da se smrzneš* (aty, 373-374, shih edhe DD,I,153).

5.3.0. Aspekte të kalkimit të frazeologjizmave gjuhësorë

5.3.1. As frazeologjizmat si kategori të veçanta e si njësi leksikore specifike, as frazeologjia si fushë e funksionimit semantik të tyre, s'u shpëtuan në ligjërimet serbe të Kosovës dukurive e pasojave që u shkaktuan nga kontaktet e ngushta me shqipen. Ky fakt, nga këndvështrimi i intererencave ndërmjetgjuhësore, del me rëndësi të posaçme ngase dihet që frazeologjia përrën një nga rrafshet dhe treguesit më të ndjeshëm të pasqyrimin të tipareve të mëvetësishme, burimore, komëtare të çdo gjuhe, si në pikëpamje të ndërtimit strukturor, ashtu edhe të pikënisjes origjinale semantike të sajimit të njërive të saj. Rrjedhimisht, prania e elementeve të huaja aty flet për përmasa serioze e të thella të ndikimit të jashtëm. Për trajtimin e çështjeve që përfillen në shtjellimin që kemi përpara, ka rëndësi konstatimi i studiuesve që janë marrë me frazeologjizmat si hallkë e tipareve të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit¹³, se kundrejt shqipes në këtë segment serbokroatishtja qëndron më larg se bullgarishtja, e kjo e fundit më larg se rumanishtja¹⁴. Kjo distancë e

¹² F Shih E. Çabej, Studime gjuhësore, III, 226

¹³ Shih J.Thomaj, Xh. Lloshi: *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë, 1972, 223-235 dhe literaturën e cituar aty, J.Thomaj: *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, në veçanti nënkapitullin *Disa paralele frazeologjike të gjuhës shqipe me gjuhë të tjera të Ballkanit*, 234-255.

¹⁴ Shih J.Thomaj, Xh. Lloshi: *Paralele...*, 234; J.Thomaj: *Çështje...* 254. Shih këtu (246) edhe për pasqyrimin e tipareve kombëtare në fushën e frazeologjisë.

serbokroatishtes vihet re ngase më së shpeshti frazeologjizmave të shqipes ajo u vë përballë njësi leksikore jofrazeologjike.¹⁵ Mirëpo kjo fushë, si një mikrodimension i marrëdhënieve ndërmjet dy gjuhëve, e parë në raport të shqipes me të folmet serbe të Kosovës, nxjerr në shesh edhe elemente që hedhin dritë mbi një gjendje diçka më tjetërfare të këtyre çështjeve.

5.3.2. E ndryshmja e ligjërimeve serbe të Kosovës kundrejt të folmeve të tjera të kësaj gjuhe në këtë fushë qëndron tek e vërteta se këto, si edhe në nënsistemet e tjera gjuhësore, u prekën fuqimisht edhe në këtë sferë nga tipare të gjuhëve me të cilat ishin ose janë në kontakte të vazhdueshme. Veçsë në këtë pikë, në saje të treguesve gjuhësorë përkatës, gjurmët e interferencave, qoftë si rrugë e depërtimit, qoftë si burim gjuhësor prej nga vijnë, zbulohen më lehtë.

5.3.3. E ndryshmja e paragrafit parashkues të ligjërimeve në vështrim, më shumë se me huazimin e semantemave, brendapërkohet nga e veçanta¹⁶ e shqipes në këtë fushë me kalkimin semantik të krijimit të frazeologjizmave, ndonjëherë edhe të ndërtimit, të strukturës së tyre. Kjo nga shkaku se elementi i parë, me ndonjë përjashtim të rrallë, ka karakter universal. Megjithëkëtë, këtu ka disa semantema specifike që lidhen me konstitucionin e njohur etnopsikologjik e moral të popullatës, dhe shërbejnë si mbështetje e sajimit të frazeologjizmave tipikë. Si pikëpamja, ashtu edhe ndërtimi strukturor i tyre më së shpeshti pasqyrojnë ndikimin e shqipes. Të tilla janë *besë-a*: *Pod besu je: Uzeo ga na besu* (EF,I,43) *Ti da mi daš onu tvrdu besu; Tvrdu besu što smo mi uvezali* (aty, 194); *što sam besu junak vezuvaja* (aty, 231); *Besu daja Sokolić Mustafa* (aty, 192); *No ja zalim moju mušku besu* (aty, 118). Siç shihet këtu vërehet një zgjerim i dukshëm i funksionit kuptimor të frazeologjizmave me këtë semantemë, që s'ndeshet në serbokroatishtet e tjera. Ç'është e vërteta, te këta shembuj ka edhe elemente leksikore që ndërfiten ndonjëherë në strukturën e frazeologjizmave, se janë vargje të këngëve popullore që duhet të përmbushin kriteret e metrikës, po në fakt ato ruajnë thelbin e frazeologjizmit; *gjak-u*: *Da ubijem nekoga, oću da padnem na krv* (NP,II,119); *I kad su pali na krv, resili su da se ise le odatle ovamo* (NP,I,124); *Tamo su pali na krv, i prebegli u Mačitevu* (D.D.d.d. II, 88); *Ovde mi je pobegao krvnik, pa sam dosao krv da uzmem* (NP,I,113); *Ako si istinski naumio da uzneš krv, uzmi kolombotnjo brašno* (aty); *Na krv su; Mirili krvove* (EF,I,324). Frazeologjizma të këtillë serbokroatishtja, jashtë kontakteve me shqipen, nuk ka. Ka ndonjë njësi frazeologjike të kodifikuara me vatër semantike *gjakun*, si *krv nije voda* "svoj ide svome, svoj svome prasta" (RSHKJ, 3,43).¹⁷ por kjo s'ka asgjë të përbashkët me këto më sipër; *fytyrë, faqe: Roditeljima obelio obraz-* (NP,II,60) (=osvetlio obraz, RSKHJ, 3,877); *Smrt je beja obraz* D.D.d.d.II,201) *Aferim da ti je, obelio si obraz* (EF,II,2). Më të shpeshta janë rastet e kalkimit semantik të gjymtyrëve të frazeologjizmave: *Jesi lazna pamet* (=jesi li pri svesti), *Ti boga mi, kaj da nesi na pamet; Ne drzim na pamet kako mu beše ime; Je lsi na pamet, šta činiš*

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Shih procedimin metodologjik që ndjek në këtë çështje J. Thomaj *te Çështje...*, 235-236.

¹⁷ Shkurtesë për Rečnik srpskohrvatskog književnog jezika, Novi Sad - Zareb, 1969.

to; *Ne dolazi mi na pamet* (=smetnulo mi se s uma); Od pameti ću da iskoćim; Ova mi deca isterase pamet: Oću da pomerim pamet od meraka; Držiš li na pamet, kad je bio ucitelj Anta? (EL,54-55); *Ništa mu pamet ne seče* (aty, 542); *Beri pamet* (=pamet u glavu) *da ne bereš zube* (OR, 368). Në shembuj si këta, siç dihet, në serbokroatishte përdoret, në vend të *pamet*, sinonimi *Um: luaj menç = siçi s uma, šenuti um* (ose) *umom; s'e mbaj mend= smetnuti s uma*¹⁸ etj.; *Nije mirovao jedan petao, pa mu rekli: Sedi mudro* (=miruj, budi miran) *se oće da te terau u sirgin* (NP,I,25). *Deco, ne besnite, no mudro da sedite* (EF,I,43); *Mudro, ne zadevaj se!* (aty, 421); *Ako ne sediš mudro, sad ću pustit bučku da te uzne* (aty, 69); *Ako sediš mudro, daću ti nešto* (aty, 161). *Oće da ti udari* (=da ti bude) *u vrat* (kalkim i gjymtyrës "bie"); *Uzeo si me na vrat* (=na dušu); *Ne uzimaj me na vrat* (EF,II,384); *On je negde slomijo vrat* (=otišao); *De li je slomijo vrat taj pas?* (aty,243; *On da učini boja na Kosovu; Ti da učiniš boja na Kosovu* (NKSK,JP, 73-74) 18.¹⁹ *Čini pal more mik* (EF,II,53) *Pa će i on biti fuk n dušk* (aty, 413) *Ufatiše se fit pr fit* (aty, 411); *Tebe što ti ulazi u rabotu da mu uzimaš njegova kolica* (aty, 388); *Počela i njojzi da izlazi boja* (EF,I,224); *Što rabota? Štroji muve* (=besposličii (EF,II,277); *Kad rekneš, gledaj da ti lakrdija* (=rec.-M.B.) *ufati mesto; Ne faca mu rec mesto; Udarili na rdjavo mesto; Muz na mesto* (=zreo); *Na mesto devojka; Ne faća mesto* (=uzrujan); (EF,I,40); *Pus mu je rabota* (EF,II,150), *Iskoçi mi iz ruka; oće da ti ostane u ruka; Ostavi testo neka podje po ruke; Učinio sam mu na ruku; Ako mogu da ga turim u ruke*, (EF,II,185), *Iz usta si mi izvadio; Izvadili mu pesmu; Ja ću da ti izvadim koju oćeš devojku; Najpre se izvadi devojka, pa se posle ugovara svadba* (EF,I,221); *Tako će, dok ne padne na rutav nos* (EF,II,187), *Valja da ideš da mu zdraviš glavu, Ode i ubica na zdravu glavu u kuću ubijenih* (OR,211)etj. Ndonjë prej tyre edhe mund të ketë shtrirje më të gjerë, por shihet sheshazi se ata janë sajuar në frymën e shqipes. Kanë ngjashmëri edhe me frazeologjizma në rrafshin ballkanik, por me mjaft tipare karakteristike lidhen me zonat ku janë formuar. Disa prej tyre kanë karakter dialektor.

5.3.4. Ka shumë njësi frazeologjike të ndërtuara në këtë të folme me gjymtyrë, njëra prej të cilave përbëhet nga elemente leksikore të turqishtes. Ato gati rregullisht kanë paralelizma edhe me shqipen, po meqë kontributi i shqipes aty nuk është burimor, nuk do të merren në shqyrtim. Mund të merrej parasysh ndonjë segment i veçantë i tyre, si çështja e renditjes së gjymtyrëve të njësisë frazeologjike, që ndonjëherë del në kundërshtim me frymën e natyrën e turqishtes e të serbokroatishtes dhe në përputhje me të shqipes²⁰ po meqë s'formojnë tip të përhapur, nuk kanë ndonjë rëndësi për t'u veçuar.

18 Për paralelizmat ballkanike të frazeologjizmave në fjalën mend dhe afrinë e shqipes me rumanishten në këtë pikë, shih J.Thomaj: *Çështje...*, 252.

19 Shkurtesë për Narodna knjizevnost Srba na Kosovu, Junačke pesme, Priština, 1980.

20 Shih J.Thomaj: *Çështje...*, 250.

5.4.0. Gjurmë ndikimi në stilistikën gjuhësore

5.4.1. Edhe përdorimi i mjeteve të stilistikës gjuhësore, si formë e veçantë të të shprehurit e këtyre ligjërimeve, pasqyron gjurmë të caktuara të kalkimeve semantike. Këtu do të merren në vështrim shumë shkurt dy aspekte të kësaj çështjeje: përdorimi i fjalëve e i shprehjeve me ngjyrim emocional stilistik dhe ndërtimi i formulave të veçanta, ku bien në sy tipare të shqipes.

5.4.2. Me anë të metaforës gjuhësore shprehet ngjyrimi emocional stilistik qoftë me mjete leksikore të shqipes, qoftë me kalkimin e tyre: *On je bio kret baljoš* (EF,I,29); *Sta čini ona moja ćuća? Ona moja ćućajka nije se ni digla; Što ne ulegneš u sobu ćućane moj* (EF,II, 373); *Ona ćućka, propala je u muku, u sirotinju* (aty, 374); *Ne znaš što je kopilj dete; Makni se od onoga kopilja, prevariće te* (EF,I,312); *Čkuljo čkuljavi (fëmijës)* (EF,II,453); *Sas take dzailje muka je da se iskoči na kraj* (aty, 460); *Štrigulja stara (plak s)*(aty, 487); *d upa (vajzës)* (EF,II,468), *A tu li si, bre svinjski sine* (NP,I,127); *pasji sine* (NP,II,80); *Svinjski sin i pasji; Pasji sinu!* (EF,II,52) *Tu bre, što pas čovek beše bio* (EF,II.353), Për këto të fundit serbokroatishja ka përkatësisht *Svinjo jedna; Kučin sine "osoba rdjava, slaba karaktera, zlikovac"* (RSHKJ,3, 146) dhe *djavołji, kučkin, kujin, krmski, pseći, šepave kobile sin*" (aty, 767) pra shprehje shumë më e shpeshtë është *kučkin sine*. Në këtë paragraf mund të gjejë vend edhe ndonjë njësi frazeologjike, përmendur më parë si *slomija vrat, promeniya veka* (vdiq, ndërroi jetë); *Čim Momčilo promeniya veka* (DD.I,227) etj.

5.4.3. Te ndërtimi i formulave të ndryshme, i thënieve, i urimeve, mallkimeve, qortimeve etj. shpesh kalkohen semantikisht modelet e shqipes: *Sretna radnja! Sreću imao!* (EF,I,245 por jo siç mendon Elezoviçi!); *Ajt sa zdravlje kume i starejko; Ajt sa zdravlje kićeni svatovi; Ajt sa zdravlje mladi mladozenja* (SNPKM, 38) ²¹ *Na zdravlje! Zdravlje da imaš* (EF,I,206); *Bio ti obraz! "alal ti vera, svetao ti obraz!"*; *Crn ti obraz! "Sram te bilo!"* (EF,II,5); *Aferim da ti je, obelio si obaz* (aty, 2) edhe iron. *Obelila obraz kaj tamona* (aty); *Oči ti pukle* (EF,II,24) *Umukni oči ti pukle* (NP,I,155) (=ispale ti, isprisle ti); *Djete te čuda* (EF,II,456,457) etj. Edhe te fjalët e urta ndeshet ndonjë fenomen i tillë si *Dva bez duše, treći bez glave* (EF,I,162) ose ngërthen elemente leksikore të shqipes: *Ovaj svet kom prpjjet* (SNPKM, 75) etj.

²¹ Shkurtesë për Srpske narodne poslovice sa Kosova i Metohije (V.Cvetanović).

Murat Blaku

THE INFLUENCE OF ALBANIAN ON SERBIAN SPEECHES IN KOSOVA - LEXICOLOGY

S u m m a r y

This paper discusses the great amount of pressure of the Albanian language on Serbian speeches in Kosova in the field of vocabulary. Some narrow, more specific aspects of the movement to the field of semantics are observed, first of all of some verbs. The phenomenon of semantic extension, though restricted, of the verbs with close meaning is observed, when one of them can take the meaning of another, such as: *doneti - dovesti, poneti - povesti*. Here the former variants, as it can be seen from the examples, include the meaning of the latter ones. The phenomenon seems to find a basis at the similar phenomenon that can also be found in the Albanian speeches in Kosova with the verbs *bie (prura, pruri), sjell*, the former being used instead of the latter one, too.

A significant influence of Albanian on the Serbian speeches is observed in the field of phraseology and phrasal expressions. The frequency of their use in these speeches shows obviously the dimensions of interference. Loan translation of phrasal expressions reflects the semantic model, and the model of their structure. These elements in this field of lexical, as it is known, are special indicators. However, very rare tracks of Albanian influence on the speeches are found also in word formation by suffixation and in language stylistics.